

Hyrje

Forma parësore ku manifestohet gjuha është realizimi i thënieve të ndërlidhura midis tyre në mënyra të ndryshme për qëllime të ndryshme të folësve, bashkëbisedimi - këmbimi i aktiviteteve gjuhësore në situata të përditshme, shpesh të zhvilluara në kontakt pamor me bashkëfolësin. Për humanët ndërveprimi gjuhësor duket të jetë forma dalluese e këtij tipari parësor të jetës sociale dhe biseda e zakonshme është forma bazike e organizimit të të folurit gjatë ndërveprimit' (Schegloff, 1996:54).

"Komunikimi njerëzor është i qëllimshëm, ai nuk është vetëm një fakt kodifikimi dhe dekodifikimi [...] Çdo paraqitje semantike është një skemë e cila duhet të kompletohet dhe integrohet brenda hipotezës së qëllimit informues të folësit" (Sperber, Wilson, 1993 [1986]: 260-261). Komunikimi gjuhësor pra ka të bëjë thellësisht me qëllimin, qoftë në rastet më të thjeshta të një ndërveprimi mes një folësi dhe një dëgjuesi, ashtu edhe në rastet më komplekse, ku komunikimi merret në raport me sistemet sociale-kulturore (Baldi, Savoia, 2007:15).

Mbi këtë fakt të rëndësishëm orientohet interesi gjuhësor për ndërveprimin: nëse bashkëbisedimi është kaq i rëndësishëm, patjetër duhet të ketë lënë gjurmë në strukturat gjuhësore ose, po të niseshim nga supozimi i themeluesve të analizës së bisedës se struktura të ndryshme të gjuhës janë projektuar pikërisht për t'i shërbyer bisedës, atëherë, përpara gjuhëtarëve hapet një fushë e rëndësishme për studim (Sacks, Schegloff e Jefferson, 1994, Schegloff 1996, 2007, Ford & Thompson, 1996, Selting 2005, Auer 200, 2005, Lindström, 2006, Bregasi, 2015, etj).

Nga arritjet e deritanishme të analizës së bisedës janë zbuluar pika të rëndësishme të lidhjes mes organizimit të njërive të ndërtimit të radhës (NJNR) dhe sintaksës së fjalisë. Organizimi i radhëve në bisedë është interaksionalisht i ndjeshëm ndaj përshkrimit sintaksor të strukturës së fjalisë në shqipe.

Pjesë të veçanta të strukturës gramatikore mund të përdoren nga folësit për të kryer veprime të veçanta në sistemin e marrjes së radhës (turn-taking system). Pjesë të ligjëratës mund të përdoren nga folësit si elemente hyrës, lidhës, nxitës etj.

Sacks, Schegloff e Jefferson (1974) propozuan një strukturë tri pjesëshe të një radhe në bisedë "njëra e cila e adreson lidhjen e radhës me atë paraprijëse, njëra që merret më atë që zhvillohet në radhën aktuale dhe e

trëta që adreson lidhjen e radhës me atë që do ta pasojë (Sacks, Schegloff e Jefferson, 1994:722)”. Ky është tipari më i dukshëm i radhës, që na shpie drejt strukturës themelore të saj me elementë të identifikueshëm hyrës e përmbyllës.

Duke u nisur nga ideja e Sacks e tj. (1974) se marrja e radhës varet nga tipari i projektueshmërisë së saj si nga folësi, ashtu edhe nga dëgjuesi, kam analizuar lidhjen midis plotësisë sintaksore dhe vlerësimit të folësit për NJNR. Pasi ky është fonti kryesor i gjuhësisë që kërkon analizë e mbikqyrje për të dhënë një kontribut dykahësh, si në analizën e bisedës, ashtu edhe në sintaksë.

- Nisja e një radhe dhe elementët paranisës

Tipari themelor i bisedës është se ajo ndërtohet nga radhë në të folur. Radha në bisedë është një proces normativ që duhet arritur nga pjesëmarrësit në bisedë (Liddicoat, 2008:51). Ajo është njësi bazë e ndërveprimit gjuhësor dhe tregon atë hapësirë kohore në bisedë që i takon një folësi (Franceschini, 2008:30).

Radhët në një bisedë paraqiten me forma e ndërtime të ndryshme, nga më të thjeshtat, që përbëhen edhe nga thjesht një njësi leksikore, deri te ato më komplekset, të cilat përbëhen nga disa NJNR. Si radhë të thjeshtë apo njëshe në bisedë do të quanim atë radhë që përbëhet vetëm nga një NJNR, pra që mund të jetë një fjali e thjeshtë, një periudhë, një sintagmë, një fjalë e vetme si edhe vetëm një element gjestikativ pas të cilit ndodh tranzicioni.

Trans: Shamia

01 D: Un jam ende e shokume

02 C: = [Për çka je e shokuar?]

03 D: [prej shprehjes to:nde] rrugaçri./

04 C: =Rrugaçëri [gazetareske?/ A s=ki n=Kosovë?

Sikurse paraqitet edhe në transkriptim, te rreshti 2 dhe 3 kemi mbivendosje mes palës C dhe D, kjo tregon se radha e parë e palës D është paraqitur në transkript si dy radhë të ndara, në të vëretetë në rreshtin 3 kemi vazhdim të radhës së parë së cilës i është mbivendosur radha e parë e palës C (rreshti 2). Pra realisht radha e parë e palës D përbëhet nga dy njësi ‘Un jam ende e shokume./ prej shprehjes to:nde rrugaçri./ ‘ gjatë së cilës ka ndodhur mbivendosja me një njësi të palës C. Te të dyja këto radhë kemi nisje direkte të njërive, pa elementë të tjerë të ndajstuar, për të cilët do të flasim në vazhdim, por do të shohim se nuk ndodh gjithmonë kështu.

Duke marrë shkas nga modeli tri pjesësh i një radhe sipas S. S. J., (1974: 722), që thotë se pjesa e parë e saj lidhet me radhën paraprijëse, pjesa e mesit ka të bëjë me atë që do të zhvillohet në këtë radhë, pra me substancën

reale të kësaj radhe, dhe pjesa e tretë i referohet radhës që do të vijë më mbrapa, do të ndalemi më gjerësisht, duke treguar se si këto tri role mund të zhvillohen edhe brenda vetëm një NJNR. Shembulli që dhanë Sacks e tj. (1974) është ky:

1. Shembull Sacks etj., (1974, p. 722)

- 01 **A:** It would bum you out to kiss me then, [hunh
02 **B:** [Yeah well we all know where that's at.
 ((pause))
03 **A:** [[()
04 **B:** [[I mean you went- you went through a- a long rap
05 on that one.=
-> **A:** =Yeah, so I say that would bum you out then, hunh

ku në radhën e markuar me shigjetë e cila përbëhet nga vetëm një NJNR dallojmë këta elementë: 'Yeahh', që është një mjet lidhës formal me radhën paraprijëse, 'hunh' është një 'tag question' që projekton një lidhje me radhën e ardhshme dhe '(so) I say that would bum you out then' është ana substanciale e kësaj radhe. Nëse do t'i hiqnim këta elementë 'Yeahh', 'so' dhe 'hunh' të cilat kanë funksion bukur të qartë në ndërveprimin gjuhësor, atë të organizimit, por jo edhe funksion dallues semantik, do të mbetej vetëm ana substanciale e kësaj radhe. Pikërisht anën substanciale të njësisë do ta marrim edhe si njësi bazë të ndërtimit të një radhe, pra atë NJNR e cila nuk ka elementë dallues para- apo pas- lidhës me radhët e tjera. Duke iu rikthyer shembullit të mësipërm themi se të dyja radhët e para të palëve D dhe C janë njësi bazë të ndërtimit të radhëve, pa elementë shtesë paranisës apo pasmbyllës.

Më poshtë japim modelin e njësisë së ndërtimit të radhës të krijuar nga Lindström (2006:83) e cila është mbështetur te udhëzimet e Schegloff (1996) dhe te tipologjia e marrjes së radhës praqitur nga Steensig (2001):

Një njësi e mundshme e bisedës		
Segment i paravendosur që lidh NJNR me radhën paraprijëse	NJNR pjesa kryesore Fillimi (para)Plotësia	Segment i paravendosur që lidh NJNR me radhën e ardhshme
Yeah, so Po, kështu	I say that would bum you out then, Them se ajo...	Hunh Apo jo

Në lidhje me këtë model Lindström thekson: 'Funksionet e pozitive të paraqitura në figurë nuk janë të bazuara në gramatikë, por kanë të bëjnë me praktikat e marrjes së radhës, për shembull, kanë të bëjnë me njohjen e pikës relevante të mundshme të transferit dhe me vendosjen se kush e ka të drejtën për këtë. Këto pozicione nuk janë vetëm mundësi për folësin, por janë gjithashtu pika themelore orientimi për praktikat e marrësit, sikurse është ajo e sinkronizimit të hyrjes me një radhë të re' (Lindström 2006: 83).

Është e zakonshme që nisja e radhës të karakterizohet edhe nga elementë jogjuhësorë si aspirimi, një kollitje e lehtë për të pastruar zërin apo edhe tinguj të tjerë jogjuhësorë, të cilët po ashtu i shërbejnë folësit si mjet për t'u parapërgatitur për ta marrë radhën e vet, por ato nuk kanë të bëjnë me nisjen e vërtetë të radhës. Për anglishten dhe mjaft gjuhë të tjera, elementët të cilët i përkasin klasës së quajtur apozicionare apo ndajshesore (lidhëzat, pjesë të diskursit, termat e adresimit) janë të ndërtuar sintaktikisht në ekstrapozicion dhe dallojnë nga nisja e vërtetë e fjalisë (Sack e tj., 1974:719). Këta elementë në analizën e bisedës quhen elemente paranisës (pre-strats). "Ne do të quajmë elementë paranisës - elementët të cilët projektojnë një nisje të të folurit ose fillimin e një NJNR apo një radhe të re, por ende pa qenë nisje të vërteta. Ata zënë një pozitë menjëherë jashtë një nisjeje apo menjëherë jashtë një mbylljeje të mundshme" (Schegloff, 1996:92). Pra janë ata elementë që qëndrojnë ngjitur me nisjen apo me një mbyllje të mundshme të një njësie të ndërtimit të radhës, të cilët dallohen edhe nga fakti që kanë një status sintaksor të izoluar në fjalinë ku gjenden. Këta elementë i shërbejnë folësit për t'u akomoduar në bisedë duke u përshtatur me radhën paraprijëse dhe me atë që pritet të vijë më pas, pra kanë vetëm funksion organizues e lidhës në bisedë.

Shembulli që kemi ilustruar më poshtë është marrë nga një debat televiziv në Kosovë, ku flitet për të drejtën e grave për të mbajtur shaminë nëpër institucionet publike. Pala D është kundër këtij fakti, madje kundërshton me forcë aplikimin e shamisë edhe te vajzat e vogla, marrë shkas nga një video në youtube që është filmuar në një fshat në Kosovë, në vitin 2010, që tregonte si hoxha i fshatit i mbulonte vajzat e vogla rreth moshës nëntë a dhjetë vjeçare, rast mediatik i fortë në Kosovë, që përfundoi me dëbimin e hoxhës nga vendi nga qeveria e Kosovës, pasi ishte qytetar i Shqipërisë.

Trans: Shamia

01 D: [Po t=lutem]

02 C: [↑E sjell një ligj?] jo jo jo (0.4) sillen ligjet për ata që ia

03 imponojn mbulesën dikujna↓bile un e kisha bër pa

04 dëshmitar./ vetëm le t=del njëna të deklaroi që burri e ka

05 fut (0.4) në shami (0.4) pes vjet dhet vjet pesdhet vjet

06 bëhet ligj [tjetër./ ama të lutem./

07 D: [n=Franc n=Franc] është draft ligji tridhet=e

08 [pes mi:j dollar për imponim./]

09 C: [o:: t=lutna./] trajtimi që i bën Franca dhe evropa

10 përfundimore kësaj çështje është shumë e sofistikuar për neve./=

Në rreshtin 9, radha fillon me 'o.. t=lutna' elementë të cilët i janë bashkangjitur njësisë 'trajtimi që i bën Franca dhe evropa përfundimore kësaj çështje është shumë e sofistikuar për neve', por realisht ky ndërtim nuk bën pjesë te kjo NJNR. Ky ndërtim ka status të izoluar sintaksor. NJNR përbëhet nga fjalia dëftore që fillon me subjektin 'trajtimi' (emër), ndërtim tipik i fjalisë dëftore në shqipe. O:: e zgjatur në shqip përdoret për të formuar pasthirrmat, si edhe 't=lutna' i shërbejnë folëses si mjete për të marrë radhën në bisedë, për t'u ndërlidhur me radhën pararendëse, kjo duket edhe te vendosja e këtyre elementëve që folësi i përdor gjatë mbivendosjes që i bën radhës pararendëse. Vetë shprehja 'të lutem', në shqipe përveç përdorimit të saj në formë mirësjellje e cila i paraprin një kërkesë, ka edhe një përdorim tjetër, po ashtu një formë mirësjelljeje, por që përdoret si formë paraprijëse e një kundërshtimi, çka ndodh në rastin konkret.

Lindström (2006:87) këto parasegmente që shërbejnë si paranisës të njësisë së ndërtimit të radhës i klasifikon në këtë mënyrë:

Paranisës të zakonshëm (appositionals) sikurse janë lidhëzat, pjesëza të diskursit (duke përfshirë edhe *tokens*) dhe terma adresues (thirrurët). Këta elementë nuk inkorporohen asnjëherë si përbërës në një njësi sintaksore.

Paranisës opsional si ndajfoljet me funksion lidhëz. Këta elementë mund të jenë përbërës normal të një fjalie ose si segmente të izoluar sintaktikisht.

Mjete të tjera njësi-formuese sikurse janë pjesëzat që përdoren për pyetjet, disa formate që përdoren për përgjigje. Janë projekte të ndryshme të izoluar sintaktikisht nga NJNR.

Në shqip kjo klasë elementësh, që do ta quaja klasa e ndajshuesëve, paraqitet më një varietet të larmishëm formash e ndërtimesh, të cilat mbeten gjithmonë me status të izoluar sintaksor dhe kanë funksione organizuese, përkatësisht lidhëse në bisedë. Në shembullin e mëposhtëm jepet një pjesë nga debati mbi ndarjen e buxhetit në Kosovë ku pala C është përfaqësues i qeverisë së Kosovës.

Trans: Ndarja e buxhetit

01 C: JQ. Nuk janë deputetët po është rritja ekonomike e Kosovës.

02 Nëse duam t=gjenerojm rritje ekonomike nëse dojm

03 t=krijojm infrastruktur e cila ka mi tërheq investitort në
 04 Kosovë atherë investimet ma të madhja janë orientuar në
 05 investime kapitale’
 06 A: Mirë A:: nuk kanë mujt me nis prej prej për shembull prej
 07 sektorve tjerë si [puna e shëndetsis, policis, gardianëve
 08 të burgjeve]
 09 C [Po/ (1.4) po/. Un/ un] un e ceka edhe
 10 më herët se. krahas do të thotë, orientimit të investimeve
 11 kapitale janë edhe disa zhvillime shumë pozitive ndisa
 12 sektor. E përmendëm sektorin e arsimit ku rritja ka qenë
 13 [afërsisht rreth tridhjet për qind]

Në radhën e palës A, rreshti 6, kemi një element i cili është bashkangjitur njësisë, elementi ‘mirë’ në këtë rast i shërben palës vetëm si mjet lidhës me radhën pararendëse, kjo vërehet edhe në humbjen e kuptimit të mirëfilltë semantik që ka kjo ndajfolje, atë të aprovimit, pasi në këtë radhë pala A kundërshton palën pararendëse për mënyrën se si e kanë ndarë buxhetin, që sipas kësaj pale do duhej bërë më ndryshe.

Po ashtu edhe në radhën e folësit C, rreshti 9, kemi lidhëzën kundërshtuese ‘po’ e cila përsëritet pas një pauze (1.4) që e humbet rolin e saj sintaksor, pasi ajo në këtë mbivendosje luan më tepër rol për marrjen e radhës, kjo vërehet edhe te fakti se pas mbivendosjes, folësi C e rifillon njësinë e tij të radhës.

Në debatet e analizuara gjendet një mori elementësh, fjalësh apo edhe segmente fjalësh, të cilat u shërbejnë folësve pikërisht si mjete të rëndësishme funksionale në bisedë: a?, mirë, vetëm pak, pra, atëherë, përsëritja e një fjale apo përsëritja e një ndërtimi sintaksor etj. Është i nevojshëm një studim i mëtutjeshëm statistikor për ta parë hollësisht nga cilat pjesë të ligjëratës formohet kjo klasë elementësh dhe çfarë funksionesh të tjera luajnë përveç atij lidhës.

- Elementët mbyllës e pasmbyllës të NJNR

Sikurse është vënë në dukje në shumë punime në analizën e bisedës, tranzicionet e zakonshme, pa pengesa, “në kohë të saktë” (Lindstrom, 2006:98) nuk do të ishin të mundura nëse plotshmëria e një radhe nuk do të ishte në një farë mënyre e parashikueshme nga ndërvepruesit në bisedë (shih Jefferson, 1973, 1984). Ne i përmendëm në kapitullin e organizimit të radhëve, faktorët që ndikojnë në plotshmërinë e një njësie të ndërtimit të radhës, pra faktori intonacionar, sintaksor, pragmatik si edhe shpesh gjestikulacioni, të cilët në bashkëveprim me njëri-tjetrin u bëjnë të mundshme palëve në bisedë që të organizojnë radhët e tyre. Vetë karakteri linear i sintaksës u bën të mundur palëve në bisedë ta parashikojnë

përmbylljen e një njësie që është duke u ekzekutuar. Po marrim shembullin më poshtë për të ilustruar këtë orientim të palëve, një shembull të ngjashëm e kemi marrë edhe më sipër gjatë punimit, kur kemi folur për mbivënien progresive, por tani do ta shikojmë nga një kënd tjetër analizën.

Trans: Ndarja e buxhetit

01 C: [Po përgatitja e buxhetit bëhet në bazën e një mbi baz::]

02 Përgatitja e buxhetit është bërë mbi bazën e një strategjie të

03 një dokumenti që quhet korniza afatmesme e

04 shpenzimeve. Në at kornizë neve i kemi përcaktuar edhe

05 prioritetet e qeverisë së Kosovës për dy apo tre vitet e

06 ardhshme. dhe në këtë rast prioritetet =

07 A: £=Jan deputetët

Në debat bëhet fjalë për ndarjen e buxhetit nga ana e qeverisë së Kosovës, pala C është përfaqësues i qeverisë, pala A është gazetari që drejton debatin. Në rreshtin e katërt të radhës së palës C, kemi një zgjerim të NJNR që kishte filluar në rreshtin e katërt me 'Në at kornizë neve i kemi përcaktuar edhe prioritetet e qeverisë së Kosovës./ për dy apo tre vitet e ardhshme./' e cila ka tejkaluar dy pika të mundshme të transferit, sikurse vërehet edhe nga shenjat që tregojnë plotësi sintaksore (/) dhe intonacionare (.) të mundshme, me njësinë tjetër 'dhe në këtë rast prioritetet' e cila ndërpritet nga pala A duke u plotësuar me njësinë 'Jan deputetët'. Duke u shkëputur nga faktori pragmatik, pra që gazetari realizon një ironi ndaj palës C si edhe ndaj qeverisë që ai përfaqëson duke plotësuar radhën e tij me 'Jan deputetët', pra prioritetet për qeverinë e Kosovës janë deputetët, gjë që sigurisht nuk mund ta kishte projektuar pala C dhe kjo vërehet edhe në vazhdimin e më tutjeshëm të bisedës që do ta tregojmë më poshtë, do të përqëndrohemi te faktori sintaksor që ndikon në plotësinë e vetëm kësaj njësie, pra 'dhe në këtë rast prioritetet', duke lënë mënjanë lidhëzën bashkërenditëse 'dhe' e cila, kuptohet që ka vetëm funksion lidhës dhe bashkërendues.

Pala A duke ndjekur radhën e palës C e veçanërisht njësinë që fillon në rreshtin 3, e kupton se pas pjesës 'në këtë rast prioritetet' mungon predikati emëror, të cilin ajo e vendos në pozitën e vetë menjëherë, madje duke e ndërprerë palën C, duke e përzgjedhur atë predikat sipas interesit të vetë.

Mundësia e parashikimit të fundit të njësisë varet nga projektimi sintaksor po aq sa edhe nga njohja pragmatike (Lindström, 2006:100). Rasti i mësipërm tregon ndërveprimin e gramatikës me organizimin e bisedës, pra një nisje të parakohshme të radhës së ardhshme, që nuk pritët të ndodhë, e cila mund të shpjegohet vetëm si një strategji në organizim. Një numër i pikave të mundshme të plotësisë së mundshme sintaksore

mund të kalojnë pa u shenjuar si pika të mundshme plotësie të radhës; si ndodhi që folësi i ardhshëm ta shfrytëzonte këtë rast për të bërë një nisje të parakohshme? (Schegloff, 1996:84). Nga këndvështrimi i organizimit të bisedës, një nga detyrat kryesore të gramatikës apo sintaksës është të sjellë ndërtime të mundshme dhe tregues njohës për realizimin e një pike të mundshme të plotësisë të një NJNR dhe të një radhe të mundshme (Schegloff, 1996:87).

Pala A e ka projektuar se pas kryefjalës ‘prioritet’ qëndron predikati emëror të cilin ajo vendos ta vërë në pozitën e vetë duke e përzgjedhur në përshtatje me atë që kjo palë ka projektuar. Kjo na bën të kuptojmë se pjesa ‘në këtë rast prioritet’ ka pësuar një *parambyllje* të mundshme që ka ndodhur me ndërprerje para se ajo ta arrinte pikën e saj të plotësisë së mundshme e njëkohësisht e ka arritur pikën e saj të mundshme të plotësisë sintaksore, intonacionare e pragmatike, por jo me anë të segmentit përmbyllës që kishte projektuar pala C. Këto raste Schegloff (1996) i quan raste të mundshme parapërmbyllëse (pre-possible completion) dhe i sheh si strategji që folësit i përdorin në organizimin e bisedës. Në shembullin e mësipërm, kjo strategji përdoret pikërisht për të ironizuar në mënyrë shumë të efektshme. Efekti që bën ironia reflektohet edhe në të qeshurat që shpërthejnë në debat, madje edhe te vetë pala C e cila e rimerr radhën po ashtu duke qeshur

Trans: Ndarja e buxhetit

(vazhdim i debatit të mësipërm)

08 C: *Ë jo. Nuk jan deputetët po është rritja ekonomike e*

09 Kosovës. Nëse duam t=gjenerojm rritje ekonomike nëse

10 dojm t=krijojm infrastruktur e cila ka mi tërheq investitort

11 në Kosov athere investimet ma t=madhja jan orientuar në

12 investime kapitale’

13 A: Mir a:: nuk kan mujt me nis prej prej përshembull prej

14 sektorve tjerë si [puna e shëndetsis, policis, gardianëve
t=burgjeve]

Sikurse shihet gjithë segmenti me të cilin nis radha e palës C, e cila edhe pse e kundërshton ndërhyrjen e palës A, shoqërohet nga buzëqeshja.

E nisa nga ky rast, ta quajmë ekstrem, pra një rast ku ndodh vërshim i folësit të ardhshëm mbi radhën që po ekzekutohet, kur kjo e fundit nuk e ka arritur pikën e mundshme të plotësisë, për ta pasur më të qartë idenë e projektimit të njësive që folësit bëjnë në bisedë, një projektim që nuk bëhet vetëm nga ai që e ka fjalën, por edhe nga dëgjuesi apo dëgjuesit. Dihet që sukseesi i komunikimit është dydimensional, varet sa nga folësi (jo vetëm

ajo që thotë, por edhe nga ajo që synon të thotë), ashtu edhe nga dëgjuesi (jo vetëm nga ajo që efektivisht dëgjon, por edhe nga ajo që di apo do të ndërhyjë).

Pikërisht bazuar mbi këtë fakt, folësit duke njohur rregullat gramatikore të gjuhës që përdorin, elementet prozodike dhe kuptimin që ato formësojnë, sikurse edhe veprimet pragmatike që ata realizojnë nëpërmjet gjuhës, arrijnë ta përcaktojnë pikën apo zonën ku mund të ndodhë një transfer i mundshëm, pra që nënkupton edhe plotësinë e mundshme të njësisë apo të gjithë radhës që po ekzekutohet.

Zona ku ndodh transferi karakterizohet nga një sërë dukurish që ndodhin gjatë saj si mbivënia, pauzat e zgjatura të ashtuquajtura ‘shtatzane’, ndërprerje, apo edhe tranzicione të thjeshta, të cilat nuk karakterizohen nga asnjë lloj pengese. Në rastin e mëposhtëm, marrë nga debati mbi punësimin e grave, ku pala A është gazetarja, pala D një prej debatuesëve, kemi një tjetër rast të parambylljes së njësisë pa e arritur pikën e saj të mundshme të transferit, si shkak i mbivendosjes.

Trans: Punësimi i grave

01 **A:** Domethan gruja n=Koso:v vazhdon me i pas dy opcione?

02 duhet me vendos karie:r a[po]

03 **D:** [Ose.] ose./ Nuk ka [aty t=dyjat]

04 **A:** [edhe fakti]

05 që kur i thuhet karrieriste edhe mendohet n=njifar

06 ↑mnyre’

07 **D:** Po. n=mnyr pezhorative

08 **A:** e keqe

Në rreshtin 1, paraqitet radha e parë e palës A, e cila pasi e ka kaluar një pikë të plotësisë së mundshme sintaksore si edhe pragmatike ‘Domethan gruja n=Koso:v vazhdon me i pas dy opcione?’ por që duket se nuk është edhe pikë e plotësisë së mundshme e njësisë, pasi intonacioni i ngritur në fund të njësisë tregon se pala nuk e ka projektuar aty pikën e mundshme të plotësisë, e kjo kuptohet edhe nga pala tjetër, pasi në atë pikë nuk ndodh asnjë tranzicion, pala A vazhdon ta zgjerojë njësinë me pjesën tjetër ‘duhet me vendos karie:r a[po’]. Por pa e arritur pikën e plotësisë së mundshme të njësisë, pasi pas lidhëzës bashkërenditëse apo pritët të vijë elementi tjetër bashkërendor i elementit ‘karierë’, pikërisht pas rrokjes së parë të lidhëzës ‘a’ ndodh mbivendosja nga pala D, duke bërë që edhe në këtë rast të kemi një parambyllje të mundshme të radhës.

Radha e parë e palës D që fillon me njësitë ‘ose. ose’, nuk është gjë tjetër, veçse vazhdim i radhës së mëparshme të palës A, por që realizohet vetëm me anë të një lidhëze bashkërenditëse dyshe ‘ose...ose’ por pa u shoqëruar

me elementët e tjerë që ato lidhin, që për strukturën e shqipes mund të jenë emra, mbiemra, përemra ose ndajfolje apo edhe dy sintagma apo dy fjali. Edhe pse këta elementë mungojnë, në rastin tonë duhet të ishin emra, pasi elementi i parë i ndërtimit të filluar nga pala A është 'karrierë', pra edhe elementi i dytë duhet të ishte një emer, e në bazë të kontekstit mund të ishte 'nënë', pasi kishim të bënim me një ndërtim të tipit 'ose karrierë, ose nënë', ato janë plotësisht të nënkuptueshme për palët në bazë të kontekstit që i ka paraprirë.

Folëm për raste të parambylljeve të njësive, të cilat ndodhin si strategji në bisedë, Schegloff i shikon si strategji që folësit përdorin për të korrigjuar dicka në radhë, sikurse patëm në shembullin e parë. Në shembullin e dytë kemi të bëjmë me parambyllje që ndodh si shkak i mbështetjes që i bën pala D palës A, madje kjo mbështetje vërehet edhe në njësinë e dytë të radhës së saj 'nuk ka aty t=dyjat', e cila është vetëm një përsëritje e re e argumentit, që në këtë rast shërben vetëm për ta përforcuar atë. Pra e gjithë radha e palës D, edhe pse është e ndërtuar nga dy njësi të ndërtimit të radhës, është vetëm një zgjerim i mëtutjeshëm i radhës së palës A.

Por transferi zakonisht ndodh pasi pala që është duke folur e ka arritur pikën e mundshme të plotësisë. Ky transfer mund të ndodhë pa ndonjë pengesë ose me mbivënie duke krijuar kështu një zonë që do të shërbejë si zonë tranzicioni për të kaluar nga një radhë te një radhë tjetër. Kjo zonë e tranzicionit është shumë e rëndësishme për disa arsye, por që për momentin do të përqëndrohemi te roli që ajo luan për të veçuar elementet shtesë që pala që ka radhën mund t'ia ketë ngjitur në fund NJNR, por që nuk janë pjesë e njësisë, pra bëhet fjalë për elementet parapërmbyllëse.

Trans: Shamia

- 01 C: Sepse mendoni që është [mendim]
 02 D: [Pra s=qenkeni] tolerante=
 03 C: = s=jam tolerante./
 04 D: =Se une nuk po mendoj si ti? Ti s=duhesh me m=toleru?
 05 [a po?]
 05 C: [Padrejtisira] në atë aspektin që kombet e botës i kanë
 06 lënë shekuj më par n=mesjet mbara ↑s=muna me qen un
 tolerante.

Dy palët C dhe D debatojnë për çështjen e simboleve fetare, pala D është kundër mbajtjes së shamisë në vendet institucionale dhe pala C është pro kësaj të drejte të gruas islame. Rreshti 4 është i rëndësishëm për analizën tonë. Pasi radha paraprijëse e palës D, rreshti 2, është ndërprerë nga pala C, shihet simboli (=) para radhës që tregon për mungesën e hapsirës kohore mes fundit të njësisë së palës D 'pra s'qenkeni tolerante' dhe nisjes së

radhës së palës C ‘= s=jam tolerante’, kemi sërish ndërprerje të radhës së palës C nga pala D, rreshti 4, me një NJNR e cila përbëhet nga një fjali e përbërë shkakore me rend të përmbysur, ku pjesa e varur vendoset para asaj kryesore, si strategji për ta theksuar më tepër shkakun. Kjo vërehet edhe te lakorja e tonit që e përmbyll këtë pjesë, siç vërehet në transkript, që në fund të kësaj pjese vjen duke u ngritur dukshëm. Pjesa kryesore e fjalisë ‘ti s=duhesh me m=toleru?’ e ka arritur edhe pikën e mundshme të plotësisë intonacionare, sintaksore e pragmatike, por nuk shënon fundin formal të njësië, pasi asaj pala D i shton edhe një element tjetër ‘a po?’, i cili e shndërron fjalinë në fjali pyetëse. Pra elementi ‘a po?’ luan rolin e tag question në anglishte, të cilin pala ka projektuar ta përdorë si mjet për të përzgjedhur folësin tjetër.

Megjithatë elementi ‘a po’ nuk bën pjesë në NJNR të kësaj radhe, ai ka status të izoluar sintaksor, kjo vërehet edhe nga kufiri i intonacionit të kësaj pjese, e cila përmbillet me ton pyetës edhe pse më të ulët se ai i elementit fundor ‘a po?’, i cili në shqip mjafton për ta shndërruar fjalinë në një fjali pyetëse. Çdo fjali pohore në shqipe mund të shndërohet në fjali pyetëse vetëm në bazë të tonit i cili i mbivendoset asaj. Që NJNR të kësaj radhe e ka arritur pikën e mundshme të plotësisë përpara elementit ‘a po?’ vërehet edhe te nisja e njësisë pasardhëse të palës C. Pikërisht ky element gjatë të cilit ndodh edhe mbivendosja, tregon rolin e vërtetë që ai ka për radhën ku realizohet, që është ai organizues e lidhës mes dy radhëve të një pas njëshme, por edhe si një intensifikues i pyetjes.

Përveç këtyre elementëve, që kanë rol të ngjashëm me atë të ‘tag questions’ në anglishte, ekziston edhe një klasë elementësh të tjerë që kur vendosen në fund të një NJNR, pasi ajo ka arritur pikën e saj të mundshme të plotësisë gramatikore, intonacionare e pragmatike, luajnë po të njëjtin rol, pra kanë funksion organizues, lidhës në bisedë. Ekzistojnë forma të tjera të të folurit, vendosja dhe organizimi i të cilave duhen kuptuar, më duket mua, si referencë me atë që duket të jetë një pozicion gramatikor në njësinë e ndërtimit të radhës- parapërmbyllje e mundshme, sikurse ndërprerjet, disa plotësi kolaborative të përshkruara nga Lerner (1987,1991), pauza ‘shtatzënë’ te disa folës gjatë së cilës ata ‘planifikojnë’ një NJNR të ardhshme dhe përgatiten për një vërshim-përmes radhës ku të mund të duken të përgatitur, etj (Schegloff1996:87).

Trans: Shamia

01 D: → Ka mejtepe.

02 C: =Pse du[het?]

03 D: [Ka shkolla private.

04 C: Ps` un nuk e kuptoj e[dhe nji gjë?]

05 D: [zgjidhjen e kan] edhe nje[rzt e

06 kan bo një zgjidhje private]
 07 C: [qysh e
 08 kan zgjedhjen? me shku n=me]drese./ Xheraldi[na ë?./
 09 D: Pse mos me shku?
 10 C: E pse duhet na me prodhu medresante Xheraldina?
 11 Pse (0.3) afro pezetmij vajza që n=Koso:v që është shifër
 12 jozyrtare por që (0.3) për afër siht mendohet t=jen n=Kosov
 13 duhet të ↑pezetmij[tat të shkojn n=medrese↓ a:?
 14 D: [Ky ligj./]ky ligj i [adresohet fëmijve
 15 n=shkolla fillore dhe t=mesme]
 16 C: [n=medrese duhet me
 17 shku Xheraldina ë?]

Në rreshtin 7-8 kemi një radhë interesante të palës C e cila e ndërton atë me dy njësi ‘qysh e kan zgjedhjen?’ dhe ‘me shku n=me]drese./ Xheraldi[na ë?’. Pas njësisë së parë, edhe pse është njësi e plotë si në aspektin gramatikor, intonacionar e pragmatik, kemi të bëjmë me një pyetje direkte për palën D, por që nuk ndodh transferi, pasi kemi të bëjmë me mbivënie dhe pala D është ende duke folur, ndaj pala C e vazhdon radhën me një njësi tjetër ‘me shku n=me]drese./ Xheraldina ë’, e cila nga aspekti pragmatik është përgjigja e pyetjes paraprijëse, pra pala C ka realizuar njëkohësisht dy role, atë të palës pyetëse dhe atë të asaj që përgjigjet, pasi nuk ka ndodhur transferi. Elementët e fundit të njësisë së dytë ‘Xheraldina’ dhe ‘ë?’ janë elementë ndajshesorë të njësisë, ata nuk bëjnë pjesë te njësia e nuk kanë rol në ndërtimin e kuptimit të saj, kanë status të izoluar sintaksor, por janë aty si elementë organizues për të cilët kemi folur më lart. Edhe tranzicioni ka filluar të ndodhë në rrokjen e fundit të ndajshimit Xheraldina, një element shtesë ky tregues. Këta dy elementë quhen elementë pas-përmbyllës të mundshëm, pasi vihen pas pikës së mundshme të plotësisë.

Duke analizuar me kujdes elementët që mbyllin një radhë si edhe ata që fillojnë radhën e ardhshme vëren se ata janë shumë të lidhur njëri me tjetrin. Përgjithësisht nisjet e radhëve janë të dizajnuara për të prodhuar projekte dhe lidhje për radhët që do t’u pasojnë (Sacks e tj., 1974:722-3). Ekziston shpesh një lidhje semantike, leksikore dhe/ose fonologjike midis elementëve përmbyllës të një radhe dhe elementëve nisës të radhës së ardhshme (Schegloff, 1994:95).

Nga shembulli i dhënë më sipër po veçoj këto dy radhë:

02 D: [pra s=qenkeni tolerante
 03 C: = s=jam tolerante./

të cilat tregojnë qartë se si fundi i radhës që paraprin, projekton fillimin

e radhës që do ta ndjekë.

Në shembullin që analizuam më sipër, po veçoj sërish vetëm dy radhët me të cilat u morëm më parë për të analizuar më në gjerësi edhe dy aspekte të tjera, fillimisht lidhjen mes elementeve të fundit të radhës paraprirëse me ato të nisjes së radhës në vijim e pastaj zonën e tranzicionit:

- 05 D: [zgjidhjen e kan] edhe nje[rzt e
06 kan bo nji zgjidhje private]
07 C: [qysh e
08 kan zgjedhjen? me shku n=me]drese./ Xheraldi[na ë?./

Elementi nisës i mbivendosjes nga pala C merret pikërisht me subjektin e fjalisë së njësisë së parë të palës D, pra me ‘njerzit’ për të cilin ajo pyet se cila është kjo zgjidhje që ata kanë, pra njerëzit. Po ta paraqisnim në mënyrë lineare këtë njësi, duke përjashtuar elementet mbivendosëse do të kishim diçka të tillë: zgjidhjen e kanë njerëzit || qysh e kan zgjidhjen?. E përjashtova segmentin që mbetet në zonën e tranzicionit të radhës së palës D, për arsye se pala C i është mbivendosur para se ajo të ndodhte, pra ai segment ka mbetur nën hijen e fillimit të radhës së palës C, ashtu sikurse e shpjegon edhe Schegloff (1994: 96): Por ne kemi parë gjithashtu se mbylljet e njësisë jetojnë nën hijen e nisjeve të radhëve të ardhshme nga ana e marrësve dhe se nisjet e radhëve mund të merren përgjithësisht me mbarimet e radhëve të cilat u paraprijnë.

Trans: Shamia

- 01 D: Un jam ende e shokume
02 C: = [për çka je e shokuar?
03 D: [prej shprehjes to:nde] rrugaçri./
04 C: =rrugaçëri [gazetareske?/ a s=ki n=Kosov ë?
05 D: tu mu drejt`tu drejtu n=shprehjen teme [që thash
06 me shku n=shkolla private]
07 C: [Jo./ jo./ un
08 s=tu drejtova n=shprehjen tëne./

Analizën do ta përqëndrojmë mes rreshtit 5 dhe 6. Fillimisht duhet sqaruar se radha e palës D që paraqitet në rreshtin 5 ka filluar dy radhë më herët, që në rreshtin 1, pastaj ajo sikurse e kemi analizuar edhe herë të tjera ka pësuar dy mbivendosje, sikurse paraqitet në transkriptë, pra gjithë radha e palës D e paraqitur pa mbivënie është: Un jam ende e shokume prej shprehjes tonde rrugaçri, tu mu drejt drejtu n=shprehjen teme që thash me shku n=shkolla private.

Mbivendosja e fundit nga ana e palës C ndodh në rreshtin 5 mes dy

njësive të fundit të kësaj radhe 'tu mu drejt`tu drejtu n=shprehjen teme' dhe ' që thash me shku n=shkolla private'.

Edhe në këtë rast vërehet se njësia e fundit e radhës së D-së, ajo që ndodhet në zonën e tranzicionit, mbetet nën hijen e nisjes së radhës së ardhshme nga ana e palës C. Por le të përqendrohemi te elementët e fundit të njësisë fillestare dhe ata të fillimit të njësisë së radhës së ardhshme. Këta elementë për radhën e palës D janë '...tu drejtu n=shprehjen teme' dhe për radhën e palës C janë 'Jo./ jo./ un s=tu drejtova ' pra pala C ndërton elementët nistorë të radhës së saj pikërisht duke u marrë me elementët e fundit të radhës së palës D, në rastin konkret me kundërshtimin e këtij fakti. Por po ta vërejmë edhe gjithë këtë pjesë transkripti që në rreshtin 2, ku kemi mbivendosjen e parë të palës C ajo merret pikërisht me predikatin emëror 'e shokume' të dhënë nga pala D, për të cilin pyet: Pse je e shokume?, pastaj në dy radhët në vijim kemi

03D: [prej shprehjes to:nde] rrugaçri./

04C: =rrugaçëri [gazetareske?/ a s=ki n=Kosov ë?

Elementi i fundit i njësisë së palës D është 'rrugaçëri' e cila është ndajshim i sintagmës 'shprehjes tonde', me të cilin pala C fillon radhën e saj të re, sikurse duket edhe në transkriptim.

Pra edhe në një pjesë bisede kaq të shkurtër vërehet lidhja e fortë mes elementëve që qëndrojnë në fund të një radhe, me elementët me të cilët nis radha në vijim. Scheglof tërheq vëmendjen mbi faktin se nisjet e një radhe apo njësie si edhe mbylljet e tyre përbëjnë faktorin kryesor në formësimin e interaksionit dhe organizimit social të një zone tranzicioni dhe janë po aq objekte strategjike për organizimin sa edhe vetë radha apo njësia. Zonat e tranzicionit janë objekte gjithashtu- me formën e tyre, kohëzgjatjen, prurjen dhe limitet- duke filluar diku në një radhë apo njësi më të hershme dhe duke zgjatur deri diku në një njësi apo radhë që vijon mbas saj (Schegloff, 1994:96). Limitet e zonës së tranzicionit, përveç fillimit dhe fundit të vetë zonës, shënojnë edhe fundin dhe fillimin e dy radhëve të njëpasnjëshme. Kjo zonë luan rol të rëndësishëm në korrigjimin nga ana e palës marrëse të diçkaje që duket sikur nuk shkon gjatë radhës që është duke u ekzekutuar; luan rol të rëndësishëm në rrjedhën që do të marrë biseda përta i përket objektit me të cilin ajo merret, duke kërkuar shpjegime më të hollësishme rreth një argumenti i cili po trajtohet në një radhë; ndikon në përmbylljen më të shpejtë të radhës, kjo vërehet në ritmin më të përshpejtuar që palët aplikojnë gjatë kësaj zone; në ndërprerjet e njësive pa lejuar që ato ta arrijnë pikën e mundshme të plotësisë, duke shkaktuar përmbyllje të parakohshme.

Struktura sintaksore e një radhe është e lidhur ngushtë me organizimin

[illegible]

Conclusion

The syntactic structuring of turns is strikingly related to the interactional organization of turns—presegmented and postcompleting elements, which are to be understood as devices with important turn-organizational uses. According to the CA literature (see for example Selting, 2000, Lerner, 2004, Auer, 2005, Lindström, 2006, Schegloff, 2006 etc.), and to our analysis we can notice that different structures of language are designed exactly to serve for conversation, like adverbs as turn entries, tag questions as post-completions, ‘parts of speech’ to connect elements within single turn constructional units, etc.

114—

a zone where a possible transfer might happen. Turn constituent elements needs a deeper analysis for Albanian language either from syntactical point of view, or from conversational analysis. An Albanian grammar of speech, and syntax as its basic component, opens an important area for study to linguists and a great contribution to the conversation analysis. The role of syntax is fundamental in orienting speakers into the interaction and syntax is inseparable from what is going on in interaction. One can also safely say that linguistic competence does not just involve coding and decoding of meanings: It is essential in the carrying out, identification, and synchronizing of social practices between individuals (Lindström, 2006:112).

Abstract

Conversation is a central activity to social life. Playing a key role in communication, conversation has shaped language structures. If, on the other hand we consider the assumption of the founders of the conversation analysis that the different language structures are exactly designed for the purpose of conversation, then an important area for study opens up to linguists.

The author's focus in this paper is the syntax of turns in conversation. There are remarkable points of connection between the organization of turn construction units (TCU) in conversation and the syntax of a clause. Turn organization is interactionally sensitive to the topological syntactic description of the Albanian clausal structure.

Specific parts of grammatical structure can be used by speakers to accomplish specific actions in a turn-taking system. So, parts of speech can be used by speakers as turn entries; to connect elements within a single TCU; to connect turns with each other, or to prompt a speaker to provide a sequential contribution.

The analysis is based on the transcripts of television debates which the author published in 2015.

Bibliografia

- ASHRSH**, 1995, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë
- ASHRSH**, 1997, Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë
- Auer**, P., 2000, On line-Syntax-Order: was es bedeuten könnte, die Zeitlichkeit der mündlichen Sprache ernst zu nehmen, Sprache und Literatur in Wissenschaft und Unterricht,
- Auer**, P., 2005, Syntax als *Prozeß*, Interaction and Linguistic Structures
- Baldi, B., Savoia, L.**, 2009, Lingua e comunicazione, La lingua e i parlanti, Pacini Editore
- Bregasi**, 2015, Përtej debatit politik, Analizë e bisedës, Kolegji Dardania
- Ford, C. & Thompson, S.**, 1996, Interactional units in conversation: Syntactic, intonational, and pragmatic resources for the management of turns, in E. Ochs, E. A. Schegloff and S.A. Thompson, interaction and grammar, Cambridge, Cambridge University Press (134-86)
- Ford, C., Fox, B. & Thompson, S.**, 2001, Constituency and the grammar of turn increments, in C. Ford, B. Fox & S.A. Thompson, Language of Turn and Sequence, Oxford: Oxford University Press
- Jefferson, G.**, Glossary of transcript symbols with an introduction, in G.H. Lerner Conversation Analysis: Studies from the First Generation, Amsterdam: John Benjamins (13-31), 2004
- Levinson, S.**, [1983] 1985, Pragmatics, Cambridge, Cambridge University press,
- Lerner, H., G.**, 2004 On the Place of Linguistic Resources in the Organisation of Talk-in-Interaction: Grammar as Action in Prompting a Speaker to Elaborate, Research on Language and Social Interaction, 37(2), 151-184
- Lerner, G.H.**, 1991, On the syntax of sentences-in-progress' Language in Society, vol 20 (441-58)
- Liddicoat, A. J.**, 2007, An Introduction to Conversation Analysis, Continuum, New York
- Lindström, J.**, 2006, Grammar in the Service of Interaction: Exploring Turn Organization in Swedish, 1996; Research on Language and Social Interaction, 39(1), 81-117, Cambridge University Press
- Ochs, E., Schegloff, E. & Thompson, S.**, 1996, Interaction and Grammar, Cambridge University Press
- Sacks, H., Schegloff, E., & Jefferson, G.**, 1974, A Simplest Systematics for the Organization of Turn-Taking for Conversation, Language, Vol 50, No. 4, Part 1 (696-735)
- Schegloff, E.**, 1968, Sequencing in conversational openings, American Anthropology, 70, (1075-95)

- Schegloff, E.**, 1979b, The relevance of repair for syntax-for-conversation, in T. Givón (ed), *Discourse and Syntax*, New York: Academic
- Schegloff, E.**, 1996, Turn Organisation: one intersection of grammar and interaction, *Interaction and Grammar*, Elinor Ochs, Emanuel A. Schegloff and Sandra Thompson, Cambridge University Press
- Schegloff, E.**, 2000a, Overlapping talk and the organisation of turn-taking in conversation, *Language in Society*, 29 (1-63)
- Selting, M.**, 2005, Syntax and prosody as methods for the construction and identification of turn-constructive units in conversation, in A. Hakulinen & M. Selting (Eds), *Syntax and Lexis in conversation: Studies on the use of linguistic resources in talk-in-interaction* (17-44), Amsterdam: John Benjamins
- Selting & Couper-Kuhler**, 2001, Forschungsprogramm 'Interaktionale Linguistik', *Linguistische Berichte* 187, (257-287)
- Sperber/Wilson**, 1993, Linguistic form and relevance, *Lingua* 90, 1-25